# DËSHMI ARKIVI

**A-472947**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vrasja e gjyqtarit, Elvis Shkambit i komunikohet akuza |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394397.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 06:36:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 06:31:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 06:30:00 UTC → 27 shtator 2026, 06:32:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `65f38848e3fee9432474302653600d6e8e47651a35c6b7c89796eba9009e76ad` |
| TEKSTI | `11fa722d58f23b76876f6896483b7e1644a368ff3eeb9cef9d3e7d64101839e9` |
| PAMJA | `55f183c23ea5297ae839522380bec31964231aa3ab5e82cca58312668f8912c2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `326124fd6732d1547373c295566d179099afe3074c2d0c3ede4dd3372c34f016` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f5063896df89cef7c197e5d003e6be2f1d9963e4417c199c978c5a8c380b40e8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/326124fd6732d1547373c295566d179099afe3074c2d0c3ede4dd3372c34f016`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vrasja e gjyqtarit, Elvis Shkambit i komunikohet akuza

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 27.09.2026, 08:31

Share Share



Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar të shtunën Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të detyrës”, në kuadër të hetimeve për vrasjen e gjyqtarit të Apelit, Astrit Kalaja. Shkambit, i cili ndodhet në masën e sigurisë “arrest në burg”, i është komunikuar edhe mbyllja e hetimeve për ngjarjen. Ndërkohë, ndaj tij rëndon edhe akuza për “vrasje në rrethana cilësuese” të mbetur në tentativë, për plagosjen e dy personave, babë e bir.

Gjon Shkambit, xhaxhait të Elvis Shkambit, akuza pritet t’i komunikohet të hënën. Ai ka deklaruar përmes mbrojtjes se nuk kishte dijeni për planet e nipit dhe se nuk e dinte se Elvisi do të ndërmerrte një veprim të tillë. Prokuroria, megjithatë, ka ngritur dyshime për rolin e tij në ngjarje. Në fazat e mëparshme të hetimit, ndaj Elvis Shkambit është hetuar edhe akuza për armëmbajtje pa leje.

Ngjarja ndodhi më 6 tetor 2025, rreth orës 15:40, në ambientet e Gjykatës së Apelit në Tiranë. Gjatë një seance gjyqësore, Elvis Shkambi qëlloi me armë ndaj gjyqtarit Astrit Kalaja dhe dy personave të tjerë, Ragip dhe Ervis Kurtaj, të cilët ishin palë kundërshtare në një proces pronësie. Kalaja humbi jetën, ndërsa dy personat e tjerë mbetën të plagosur. Sipas Prokurorisë, të shtënat ndodhën pasi gjyqtari kishte lexuar vendimin në çështjen ku përballeshin familjet Shkambi dhe Kurtaj.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.